




Microsoft Word është një pjesë e paketës Office 365 që lejon pedagogët dhe studentët të krijojnë shpejt dhe me lehtësi dokumente të ndryshme .


Me aplikacionin Word mund të:

- Krijojmë dokumente.
- Shtojmë tekst, imazhe, art dhe video.
- Aksesojmë dokumentet nga një kompjuter, tabletë ose telefon me OneDrive.
- Ndajmë dokumentet tona dhe punojmë me të tjerët.

Për të aksesuar tek aplikacioni word klikojmë te app:



Për të krijuar një dokument Word klikojmë tek aplikacioni word dhe selektojmë template e dokumentit mbi cilin duam të krijojmë dhe shtypim Enter.



Një tjetër opsion shumë me rëndësi është ruajtja e dokumentave në One Drive.


Kur ruajtja e dokumentave bëhet në One drive ne mund ti ndajmë dhe mund të ndërveprojmë me të tjerët dhe mund të marrim dokumentat nga kompjuteri ,tableti apo telefoni.

Më poshtë tregohen etapat për ruajtjen:

Klikojmë File > Save As.

Klikojmë OneDrive.

Ruajmë dokumentat në OneDrive dhe gjithashtu mund të shtojmë një direktori tjetër duke klikuar Add a Place.





Editimi në një dokument word.

Përdorim Stilet për titujt, paragrafët për të aplikuar një font të qëndrueshëm, madhësinë e shkronjave, ngjyrën e shkronjave dhe ndarjen në të gjithë dokumentin tuaj.






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Për të ftuar të tjerët që të shikojnë ose modifikojnë dokumentet tona zgjedhim butonin Share në këndin e sipërm të djethtë të dritares së aplikacionit. Në panelin e Share që hapet, mund të marrim një lidhje ndarëse ose dërgojmë ftesa për njerëzit që zgjedhim.




Nqs do logemi nga user i studetit atëhere do shikomin që në adresen elektronike vjen një email file share nga pedagogu .






REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Duke qënë që shpërndarja e dokumentave të Word-it që ruhen në OneDrive ndodh në kohë reale që do të thotë që ne lehtë mund të shohim se ku studentet e tjerë po bëjnë ndryshime në të njëjtin dokument me të cilin jemi duke punuar.




Më lart kemi paraqitur disa menu për cilat na shërbejnë për editimin e një dokumenti. Pra në rastin e këtij tutorial kemi zgjedhur një template të caktuar dhe kemi përdorur menu që na ofron aplikacioni.




Nëse duam vetëm të kontrollojmë drejtshkrimin, kontrollimin e fjalëve ose bashkëpunim plotësisht me studentat të tjerë, menuja **Review** zbulon komandat thelbësore për të ndjekur, diskutuar dhe menaxhuar të gjitha ndryshimet e bëra në dokumentet tona.

Gjithashtu ofrohet dhe shtimi i komenteve nëq jemi duke bërë një detyrë kursi.





Një element tjetër shumë i rëndësishëm është shtimi i komenteve. Meqëse jemi duke punuar në shared file atëherë mund të ketë paqartësi në realizimin e një detyrë kursi nga ana studentave.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Tek kutiza **Tell me what you want to do** mund të vendosim fjalë dhe fraza për atë që dëshironi të bëni më pas ose veprimet që dëshironi të kryeni.





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Universiteti i Shkodrës "Luigj Gurakuqi"

Ky tutorial u krijua për ti ardhur në ndihmë pedagoqeve dhe studentëve që të realizohet një ndërveprim më i mirë mes tyre .

Për çdo paqartësi në lidhje me web app mund të na kontaktoni tek email ynë:
it@unishk.edu.al